

AKT THEMELIMI
Për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
“ITALCONF” SH.P.K.

Sot, më datën 20.01.2025, **Z. FELICETTO SANTI** e lindur në Fossombrone, Itali me date 14 Maj 1962, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal CA38469FS, banues në Durres, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, vendosi të themelojë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar **“ITALCONF” Sh. P. K.** si më poshtë vijon:

Neni 1

Personi fizik i sipërpërmendur, me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar, krijon shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar (Sh.P.K.) me emërtimin **“ITALCONF” shpk.**

Ortake i kësaj shoqërie është **Z. FELICETTO SANTI**.

Administratore i kësaj shoqërie caktohet **Z. FELICETTO SANTI** shtetase italian, lindur ne Itali me date 14 Maj 1962, e pajisur me numer pashaporte CA38469FS. **Z. FELICETTO SANTI** emërohet administratore i shoqerise per nje periudhe 5 vjecare.

Shoqëria ka të drejtë të krijojë filiale të saja brenda dhe jashtë vendit në çdo kohë që do të vlerësohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovimin e organeve kompetente.

Neni 2

Shoqëria **“ITALCONF” SH.P.K** gëzon statusin juridik të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **“Sh.P.K.”**. Veprimtaria e saj do të zhvillohet sipas dispozitave të kësaj kontrate, statutit të saj dhe legjislacionit në fuqi.

Selia e shoqërisë **“ITALCONF” SH.P.K.** është Durres Durres DURRES Lagjja 4, Rruga Fetah Billaca, Pallati 1133, Kati i tretë, Zona Kadastrale 8514.

Statuti i shoqërisë i bashkangjitet këtij akti themelimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Shoqëria ka vulën e saj me logon dhe të dhënat të përcaktuara.


Neni 3

Veprimtaria e shoqërisë si person juridik fillon me aprovimin e krijimit të saj nga organet kompetente të shtetit dhe do të vazhdojë për një periudhë kohe pa afat të përcaktuar.

Neni 4

Shoqëria do të kryejë aktivitetet me objekt:

- Qepje konfeksionesh me material porositesi
- Dhenie konsulence teknike per qepje konfeksione.
- Hapje dhe funksionim te linjave te qepjes dhe perpunimit te konfeksioneve
- Import eksport makinerish prodhimi dhe pjese kembimi
- Import eksport, tregti me shumice dhe pakice te materialeve e konstruksioneve metalike, materialeve te ndertimit
- Çelje dhe ushtrimin e aktiviteteteve te agjensive imobiliare, turistike, detare, spedicionere, te sherbimeve me karakter social.



- Hapje dhe zhvillimi i aktiviteteve ne fushen e agjensive imobiliare, turizmit, transportit

Neni 5

Kapitali i shoqerise eshte 100.000 Leke. Kapitali i shoqerise ndahet ne nje numer kuotash ne raport me kontributin e dhene nga cdo ortak ne shoqeri ku cdo ortak zoteron nje kuote te vetme ne shoqeri, kuota keto te shlyera si me poshte:

- **Z. FELICETTO SANTI** zotëruese i një kuote me vlerë të përgjithshme 100.000 leke që përbën 100% të kapitalit të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme ose te paluajtshme apo te drejta). Ortaket pergjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 6

Fitimi neto nga aktiviteti i kësaj shoqërie i përket ortakëve të saj.

Neni 7

Për detyrimet që do të krijohen ndaj personave të tretë gjatë aktivitetit të kësaj shoqërie do të përgjigjet vetë shoqëria deri në kufirin maksimal të kapitalit të saj.

Neni 8

Marrëdhëniet e punës në shoqëri dhe në filialet e saj rregullohen nëpërmjet kontratës së punës.

Neni 9

Dispozita të hollësishme mbi organinzimimin e kësaj shoqërie përcaktohen në statutin e saj. Themeluesit e kësaj shoqërie, pasi e lexuan me vëmendje këtë akt themelimi dhe e gjetën në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me vullnetin e tyre, e firmosën pa vërejtje.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

FELICETTO SANTI

